RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Auditim tematik)

"PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN 'MBI ANKESËN E BANORËVE TË FSHATIT PISKOVË PËR VENDDEPOZITIMIN EKZISTUES TË MBETJEVE URBANE"

NË SUBJEKTET:

- ✓ **BASHKIA E PËRMETIT**
- ✓ **AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**
- ✓ **AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA**
- ✓ **MINISTRIA E MJEDISIT**

Tiranë, korrik 2026

PËRMBAJTJA

I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	3
I.1.	Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit	3
II.	**HYRJA**	3
II.1	Objekti i auditimit	4
II.2	Qëllimi i auditimit	4
II.3	Metodologjia e auditimit	4
II.4	Konkluzioni	4
III.	**ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM**	5
IV.	**KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**	25
V.	**ANEKSE**	26

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrimi i shkurtër i Raportit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit tematik me nr. 397/4 prot., datë 09.04.2026 me objekt *"*Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin '*Mbi ankesën e banorëve të fshatit Piskovë për vend-depozitimin ekzistues të mbetjeve urbane"* ushtroi auditim në subjektet, pjesë e Auditimit tematik, përkatësisht: në Ministrinë e Mjedisit; Bashkinë e Përmetit; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

Auditimi i kryer në vitin 2025, kishte si periudhë auditimi veprimtarinë nga data nga 01.01.2019 deri në 29.07.2024 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me **Vendimin nr.65, datë 03.04.2025, të Kryetarit të KLSH-së** si dhe i është përcjellë subjektit të audituar [1]me shkresën me nr.968/30 prot., datë 04.04.2025. Auditimi u krye nga data 14.04.2026 deri më datë 08.05.2026, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

1.Hartimi i programit (Plani i veprimit) me personat përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve;

2.Realizimi i programit (Plani i veprimit) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit rekomandimeve brenda afatit 6 mujor;

3.Statusi i rekomandimeve të lëna (sa rekomandime janë pranuar e nga këto sa janë zbatuar plotësisht, pjesërisht, në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar).

4. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

Në subjektet e audituar janë mbajt Akt-Verifikimet përkatësisht:

-Akt-verifikimi nr.1, datë 07.05.2026, mbajtur për Bashkinë e Përmetit;

-Akt-verifikimi nr.2, datë 08.05.2026, mbajtur për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit;

-Akt-verifikimi nr.3, datë 08.05.2026, mbajtur për Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;

-Akt-verifikimi nr.4, datë 08.05.2026, mbajtur për Ministrinë e Mjedisit.

II. HYRJA

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të evaduara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe Manualit "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve" miratuar me Vendimin nr. 67, datë 23.06.2020.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit nr. 397/4 prot., datë 09.04.2026 me objekt *"*Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin '*Mbi ankesën e banorëve të fshatit Piskovë për vend-depozitimin ekzistues të mbetjeve urbane"* për auditimin tematik, përkatësisht: në Ministrinë e Mjedisit; Bashkinë e Përmetit; Agjencinë Kombëtare të Mjedisit; Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura" për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2019-29.07.2024. Konkluzionet përkatëse janë miratuar me **Vendimin nr.65, datë 03.04.2025 të Kryetarit të KLSH-së** si dhe i është përcjellë subjekteve të audituar me shkresën nr.968/30 prot., datë 04.04.2025.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërorë të KLSH-së, me përbërje:

1. Znj.Sh.H.-*përgjegjës grupi*;
2. Z.A.D.-*anëtar.*

[1] Bashkia Përmet me shkresën nr. 968/28 prot., datë 04.04.2025;
Agjencia Kombëtare e Mjedisit me shkresën nr.968/29 prot., datë 04.04.2025;
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura me shkresën nr.968/27 prot., datë 04.04.2025.

Auditimi ka filluar më 14.04.2026 dhe ka përfunduar më datë 08.05.2026.

II.1. Objekti i auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të dërguar në subjektet: në Ministrinë e Mjedisit; Bashkinë e Përmetit; Agjencinë Kombëtare të Mjedisit; Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

II.2. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

II.3. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

II.4. Konkluzioni:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet: Bashkia e Përmetit; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Ministria e Mjedisit, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresat e sipërcituara, rezulton se 14[2](katërmbëdhjetë) masa të rekomanduara gjithsej janë pranuar 14 masat e rekomanduara nga subjektet e audituara.

Nga masa e pranuara:

- janë zbatuar 4 rekomandime, ose 29% e tyre;
- është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim ose 6 % e tyre;
- gjenden në proces zbatimi 4 rekomandime, ose 29 % e tyre;
- gjenden pa zbatuar 5 rekomandime, ose 36 % e tyre.

- *Tabela nr.1. Përmbledhje e statusit të zbatimit të masave të rekomanduara*

Nr.	**Lloji i rekomandimit**	**Pranuar**	**Statusi i zbatimit**			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1.	Përmirësim Ligjor	-	-	-	-	-
2.	Organizative	11	3	1	4	3
3.	Shpërblim dëmi	-	-	-	-	-
4.	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	-	-	-	-	-
5.	Masa Disiplinore	3	1	-	-	2
	Gjithsej masa	**14**	**4**	**1**	**4**	**5**

Përpunoi: Grupi i auditimit.

- Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

- *Tabela nr.2 Përmbledhje analitike e statusit të masave të rekomanduara, sipas kategorive:*

Nr.	**A.Statusi i masave Organizative**	Në numër	Në % brenda grupit
1.	Totali	11	100%
2.	Pa pranuar	-	
3.	Pranuar	11	100%
	Nga të pranuarat:		**Në % ndaj të pranuarave**
1.	Zbatuar Plotësisht	3	27 %
2.	Zbatuar pjesërisht	1	9 %

[2] Një rekomandim ka të përfshirë 2 subjekte.

3.	Në proces zbatimi	4	36 %
4.	Pa zbatuar	3	27 %

Përpunoi: Grupi i auditimit.

Nr.	**B.Statusi i masave disiplinore**	Në numër	Në % brenda grupit
1.	Totali	3	100%
2.	Pa pranuar		
3.	Pranuar	3	100%
	Nga të pranuarat:		**Në % ndaj të pranuarave**
1.	Zbatuar Plotësisht	1	33 %
2.	Zbatuar pjesërisht	-	
3.	Në proces zbatimi	-	
4.	Pa zbatuar	2	67%

Përpunoi: Grupi i auditimit.

III.ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN TEMATIK

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin tematik '*Mbi ankesën e banorëve të fshatit Piskovë për venddepozitimin ekzistues të mbetjeve urbane"***.**

Të analizuara dhe të detajuara sipas çdo subjekti dhe sipas llojit të masave të rekomanduara, niveli i zbatimit të tyre paraqitet si vijon:

- **BASHKIA PËRMET**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditimin në Bashkinë Përmet "Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin *'Mbi ankesën e banorëve të fshatit Piskovë për venddepozitimin ekzistues të mbetjeve urbane*", për periudhën objekt auditimi 01.01.2019 deri në 29.07.2024, përcjellë me shkresën nr.968/28 prot., datë 04.04.2025, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

1.Hartimi i programit (Plani i veprimit) me personat përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve;

2.Realizimi i programit (Plani i veprimit) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit rekomandimeve brenda afatit 6 mujor;

3.Statusi i rekomandimeve të lëna (sa rekomandime janë pranuar e nga këto sa janë zbatuar plotësisht, pjesërisht, në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar);

4.Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

-Bashkia Përmet nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", gërma j), ku cilësohet se:

"*KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*".

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Në lidhje me raportimin që Bashkia Përmet duhet të bëjë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", pika 2, ku cilësohet se:

"*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*".
-Për sa më lart, Bashkia Përmet nuk ka dërguar raportim në KLSH, në respektim të afatit ligjor brenda 6 muajve, mbi zbatimin e rekomandimeve.
Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti "Bashkia Përmet", në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr.968/28 prot., datë 04.04.2025, rezulton se, nga **6** masa të rekomanduara (organizative dhe disiplinore), janë pranuar nga subjekti **6** masa të rekomanduar.
Nga të pranuarat (6): është zbatuar plotësisht **1** masë, në proces zbatimi **3** masa dhe **2** masa nuk janë zbatuar.

Tabela nr. 3: Statusi i zbatimit të rekomandimeve

Lloji i masës	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces zbatimi	Pazbatuar
Organizative	5	1	-	3	1
Disiplinore	1	-	-	-	1
Totali	6	1	-	3	2

Përpunoi: Grupi i auditimit.

II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Nga të dhënat e paraqitura gjatë auditimit nga subjekti i audituar, përgjigjet me shkrim dhe dokumentacioni i tij, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se dosja e aplikimit për VNM paraprake dhe për leje infrastrukturore, përsa i përket venddepozitimit të mbetjeve urbane në Piskovë, ka rezultuar me mangësi në dokumentacion, kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 686, datë 29.7.2015 "*Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore*" dhe me Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 18 deri 24 të Raportit të Auditimit).*
2.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Bashkia e Përmetit të marrin masa që përpara miratimit të VNM –ve paraprake dhe lejeve infrastrukturore të verifikojnë se aplikimi i kryer është në përputhje me të gjitha kriteret sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

Përgjigje e Institucionit:

- ✓ Strukturat teknike të Bashkisë janë orientuar për zbatimin të kërkesave të ligjit nr. 10440/2011, të ndryshuar, si dhe të VKM nr. 686, datë 29.07.2015 dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015.
- ✓ Është rritur bashkëpunimi institucional me autoritetet përgjegjëse të mjedisit, për të garantuar korrektësinë dhe plotësinë e aplikimeve përpara miratimit të tyre.
- ✓ Çdo projekt i natyrave të tjera infrastrukturore i propozuar nga Bashkia Përmet i nënshtrohet verifikimit për klasifikimin nëse është subjekt i procedurës së VNM-së apo jo, si dhe ndjekjes së procedurës përkatëse (paraprake ose të thelluar).
- ✓ Bashkia Përmet gjatë kësaj periudhe nuk ka miratuar leje infrastrukturore për venddepozitim mbetjesh.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e

rekomandimit. Bashkia Përmet ka marrë parasysh rekomandimin dhe gjatë kësaj periudhe nuk ka miratuar leje infrastrukturore për vend-depozitim mbetjesh.
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht.**

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sipas Planit Kombëtar Sektoral për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr.1, datë 13.01.2020, në Bashkinë e Përmetit dhe në Bashkinë e Këlcyrës është parashikuar ndërtimi i një stacioni transferimi mbetjesh urbane. Nëpërmjet një përgjigje me e-mail (datë 11.09.2024) nga Bashkia Përmet, vendndodhja e stacionit të mbetjeve urbane nuk është miratuar ende nga institucionet kompetente. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 21 deri 22 të Raportit të Auditimit).*
3.1.Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve dhe Bashkinë e Përmetit, të koordinojnë punën për përcaktimin e vendndodhjes së venddepozitimit rajonal dhe të vijohet me ndërtimin e tij.

Brenda datës 31.12.2025.

Përgjigje e Institucionit:
Në zbatim të rekomandimit të mësipërm, Bashkia Përmet ka ndërmarrë këto masa konkrete:

- ✓ Me Vendimin nr. 5, datë 30.01.2025, Këshilli Bashkiak Përmet ka miratuar në parim vendosjen dhe operimin e Stacionit të Transferimit (ST) të mbetjeve në funksion të Zonës së Menaxhimit të Mbetjeve Gjirokastër – Vlora Jug, për Bashkitë Përmet dhe Këlcyrë, në kuadër të programit "BE për Ekonominë Qarkulluese – Programi Rajonal i Menaxhimit të Mbetjeve (EU4CE-ReËaM)".
- ✓ Është përcaktuar vendndodhja e propozuar e ndërtimit të këtij stacioni në territorin e Bashkisë Këlcyrë, me koordinata të sakta gjeografike, duke kaluar nga faza e mungesës së vendndodhjes në fazën e identifikimit konkret të saj.
- ✓ Bashkia Përmet është pjesë aktive e bashkëpunimit ndërinstitucional me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe strukturat përkatëse, në kuadër të projektit rajonal për menaxhimin e mbetjeve.
- ✓ Paralelisht, është hartuar dhe miratuar Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve (2024–2029), si dhe janë ndërmarrë masa për reduktimin e mbetjeve në burim dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të tyre, në funksion të operimit të ardhshëm të ST.
- ✓ Në vijim, Bashkia Përmet do të vijojë koordinimin me institucionet qendrore dhe partnerët e projektit për finalizimin e procedurave teknike dhe ligjore, me qëllim ndërtimin dhe vënien në funksion të Stacionit të Transferimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **është në proces zbatimi.**

4.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i kryer në venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë rezultoi se:
-U konstatua se nuk bëhet ndarja e mbetjeve në venddepozitim;
-Mbeturinat janë hedhur në mënyrë jo të rregullt dhe nuk kryhet në mënyrë permanente procesi i presimit, shtresëzimit dhe mbulimit me dhè;
-Gjatë verifikimit në vend, masat mbrojtëse në krahun nga ana e lumit, nuk janë të plota dhe të mbuluara nga dherat;

-Një pjesë e mbetjeve ndodhen jashtë gropës së venddepozitimit dhe për rrjedhojë ujërat sipërfaqësor të ndotur nga mbetjet, mund të devijojnë jashtë kanaleve kulluese;
-Venddepozitimi nuk monitorohet me personel gjatë gjithë kohës, gjë e cila mund të bëhet shkak i dëmtimit të rrethimit dhe ndërhyrjeve të paligjshme, siç është zjarrvënia, hyrja e kafshëve, në kundërshtim me ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve",* neni 43, pikat 6 e 7, neni 44, pika 3, neni 45 e 64 si dhe Vendimit nr. 452, datë 11.7.2012 *"Për Lendfillet e Mbetjeve"*, Aneksi I. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 23 deri 24 të Raportit të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa për vendosjen në kushte teknike të përpikta për operimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë si: mbulimin e mbetjeve me dhè, mbledhjen e ujërave sipërfaqësor, vendosjen e sistemit të evakuimit të gazit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

Përgjigje e Institucionit:

- ✓ Është ndërhyrë për sistemimin e përgjithshëm të venddepozitimit, duke realizuar shtyrjen, ngjeshjen dhe mbulimin e mbetjeve me dhe, me qëllim përmirësimin e kushteve teknike dhe reduktimin e ndikimit mjedisor.
- ✓ Është punuar për përmirësimin e sistemit të kullimit, përmes pastrimit dhe sistemimit të kanaleve kulluese, duke reduktuar rrezikun e shpërndarjes së ujërave të ndotura jashtë perimetrit.
- ✓ Janë marrë masa për eliminimin e mbetjeve jashtë gropës së depozitimit, duke garantuar përqendrimin e tyre brenda perimetrit të miratuar.
- ✓ Procesi i shtyrjes, ngjeshjes dhe mbulimit me dhe realizohet në mënyrë periodike, duke siguruar menaxhim më të kontrolluar të mbetjeve.
- ✓ Është vendosur sistem monitorimi me kamera sigurie që prej datës 12.07.2025, duke mundësuar mbikëqyrje 24 orë dhe duke eliminuar rastet e zjarrvënies apo ndërhyrjeve të paligjshme.
- ✓ Është caktuar një punonjës i posaçëm për mirëmbajtjen e venddepozitimit, i cili mbulon si territorin brenda, ashtu edhe zonën përreth në një perimetër prej 50 metrash.
- ✓ Janë ndërmarrë masa për përmirësimin e kushteve mjedisore përmes mbjelljes së 100 pemëve dhe është planifikuar zgjerimi i këtij procesi në vijimësi.
- ✓ Është vendosur sinjalistikë informuese dhe ndaluese në territorin e venddepozitimit, duke përfshirë ndalimin e hyrjes së paautorizuar dhe ndalimin e duhanit, si dhe informimin për monitorimin me kamera.
- ✓ Sistemi i filtrimit të ujërave ka qenë funksional, por është dëmtuar si pasojë e një zjarri të ndodhur më datë 11.06.2025. Aktualisht është planifikuar ndërhyrja për rikthimin e tij në funksion sa më parë.

Janë në proces masa të mëtejshme për përmirësimin e menaxhimit të gazrave dhe ujërave sipërfaqësorë, në përputhje me kërkesat ligjore

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Grupi i auditimit ka kryer një vizitë në vend-depozitimin e mbetjeve urbane në Piskovë në datën 07.05.2026 dhe rezultoi se:
-U konstatua se nuk bëhet ndarja e mbetjeve në venddepozitim;
-Mbeturinat janë hedhur në mënyrë jo të rregullt dhe nuk kryhet në mënyrë permanente procesi i presimit, shtresëzimit dhe mbulimit me dhè.



Foto nr.1: Venddepozitimi i mbetjeve urbane në Piskovë *Foto: Grupi i auditimit.*



Foto nr.2: Kanali i venddepozitimit të mbetjeve urbane në Piskovë *Foto: Grupi i auditimit.*

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **është në proces zbatimi.**

5.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se "Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit" në Bashkinë e Përmetit, e cila kryen grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane në bashkinë e Përmetit nuk është e pajisur me licencën III.2.B, në kundërshtim me Vendimin nr.538, datë 26.5.2009 "*Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*". Gjithashtu, Bashkia Përmet nuk ka aplikuar për leje mjedisi për venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, në kundërshtim me **VKM nr. 452, datë**

11.7.2012 "*Për lendfillet e mbetjeve*", Ligjin **nr. 10 448, datë 14.7.2011** "*Për lejet e Mjedisit*" të ndryshuar si dhe kushtit 3.23 të Vendimit të VNM paraprake. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr.20 deri 23 të Raportit të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi: Bashkia e Përmetit të marrë masa për të kryer aplikimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit, për tu pajisur me:

-Licencën për nënkategorinë III.2.B, për veprimtarinë "grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim i mbetjeve të llojeve të ndryshme";

-Leje mjedisi për venddepozitimin e mbetjeve urbane me vendndodhje në fshatin Piskovë.

Menjëherë.

Përgjigje e Institucionit:

- ✓ Është aplikuar dhe dorëzuar dokumentacioni përkatës pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe është realizuar pajisja me licencë, sipas vendimit të miratimit të datës 05.08.2025, me nr. licence LC-1423-08-2025.
- ✓ Dokumentacioni përkatës i licencimit është bashkëlidhur këtij raporti.
- ✓ Aktualisht, Bashkia Përmet është në proces për pajisjen me leje mjedisore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.

Grupi i auditimit verifikoi lejet/licencat e lëshuara nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) (*e cituar në përgjigjen e Bashkisë Përmet me nr.i aplikimit LC-1423-08-2025; nr.i licencës* ***LN-0117-08-2025***) ka si titull "*shërbime të përkujdesit komunitar Qendër për fëmije me aftësi të kufizuara*" dhe jo veprimtarinë "*grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim i mbetjeve të llojeve të ndryshme*" .

Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe nuk **është zbatuar.**

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer rezultoi se institucionet me funksion inspektimi si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nuk kanë kryer inspektime në venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë dhe në zonën e mbrojtur Parku Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli", kjo në kundërshtim me Ligjin nr.81/2017 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar, neni 38, pika 1 dhe me Ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, neni 25/1, pika 3. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr.32 deri 34 të Raportit të Auditimit*).

-Nga auditimi konstatohet se Bashkia Përmet nuk ka kryer një monitorim (të venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë), i cili të përmblidhet në një raport ku të vendosen të dhëna si: monitorimi i gjendjes në tërësi të venddepozitimit, monitorimi i gjendjes së murit mbajtës, monitorimi i sistemit të kullimit etj, në kundërshtim me Vendimin nr. 452, datë 11.7.2012 "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr.33 deri 33 të Raportit të Auditimit*).

Rekomandimi 7.3: Bashkia e Përmetit të marrë masa për të kryer monitorimin e gjendjes së venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, murit mbajtës të sistemit të kullimit të tij si dhe problematikave të tjera, për të cilat të përgatitet një raport i detajuar dhe ti dërgohet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për njohjen e situatës dhe marrjen e masave për përmirësimin e tyre.

Menjëherë.

Përgjigje e Institucionit:

- ✓ Është përmirësuar monitorimi i venddepozitimit përmes kombinimit të mbikëqyrjes fizike dhe sistemit të kamerave, duke siguruar kontroll të vazhdueshëm të territorit.
- ✓ Janë ndërmarrë ndërhyrje për stabilizimin e gjendjes së venddepozitimit, përfshirë sistemimin e mbetjeve dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese.
- ✓ Janë marrë masa për evidentimin dhe adresimin e problematikave të konstatuara në terren.
- ✓ Është përgatitur dhe po përditësohet dokumentacioni për raportimin pranë institucioneve përgjegjëse, në përputhje me rekomandimin.
- ✓ Procesi i raportimit institucional është në vijim dhe do të realizohet në mënyrë periodike.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë pjesërisht masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **është në proces zbatimi.**

C.MASA DISIPLINORE DHE ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; germat (a, b, c, ç) e nenit 58-"Llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*"; kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejtje", neni 58, pika a, për:

4.**Z. L. B.**, në cilësinë e përgjegjësit të urbanistikës dhe planifikimit të territorit, Bashkia Përmet, për moszbatimin e Vendimit Nr.452, datë 11.7.2012 "*Për lendfillet e mbetjeve*" i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 408, datë 13.5.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*".

Përgjigje e Institucionit:

Në zbatim të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", germave (a, b, c, ç) të nenit 58 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", si dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", sqarojmë se ndaj z. L. B., në cilësinë e Drejtorit të Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit, ka në masë disiplinore "Vërejtje" më datë 06.02.2026.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së: Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Bashkia Përmet nuk ka bashkëngjitur dokumentacion justifikues për masën disiplinore "Vërejtje" **për z. L. B.**
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe nuk **është zbatuar.**

III.KONKLUZIONI I AUDITIMIT:

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. nr.968/28 prot., datë 04.04.2025 në Bashkinë e Përmetit rezultoi nga 6 rekomandime (masa organizative dhe masa disiplinore) të lëna, janë pranuar nga subjekti 6 rekomandime ose 100 % e tyre. Nga këto është zbatuar plotësisht 1 rekomandim, ose 17 % e tyre, janë në proces zbatimi 3 rekomandime ose 50 % dhe nuk janë zbatuar 2 rekomandime ose 33% e tyre.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për sa më sipër, ri-kërkojmë që, Bashkia e Përmetit të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë: të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi, brenda 6-muajve.

A. MASA ORGANIZATIVE:

3.1.Rekomandimi: Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve dhe Bashkinë e Përmetit, të koordinojnë punën për përcaktimin e vendndodhjes së venddepozitimit rajonal dhe të vijohet me ndërtimin e tij.

Menjëherë.

4.1.Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë masa për vendosjen në kushte teknike të përpikta për operimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë si: mbulimin e mbetjeve me dhe, mbledhjen e ujërave sipërfaqësore, vendosjen e sistemit të evakuimit të gazit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

5.1.Rekomandimi: Bashkia e Përmetit të marrë masa për të kryer aplikimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit, për t'u pajisur me:

-Licencën për nënkategorinë III.2.B, për veprimtarinë "grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim i mbetjeve të llojeve të ndryshme";

-Leje mjedisi për venddepozitimin e mbetjeve urbane me vendndodhje në fshatin Piskovë.

Menjëherë.

7.3.Rekomandimi: Bashkia e Përmetit të marrë masa për të kryer monitorimin e gjendjes së venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, murit mbajtës të sistemit të kullimit të tij si dhe problematikave të tjera, për të cilat të përgatitet një raport i detajuar dhe t'i dërgohet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për njohjen e situatës dhe marrjen e masave për përmirësimin e tyre.

Menjëherë.

C.MASA DISIPLINORE DHE ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; germat (a, b, c, ç) e nenit 58-"Llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*"; kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejtje", neni 58, pika a, për:

Z. L. B., në cilësinë e përgjegjësit të urbanistikës dhe planifikimit të territorit, Bashkia Përmet, për moszbatimin e Vendimit Nr.452, datë 11.7.2012 "*Për lendfillet e mbetjeve*" i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 408, datë 13.5.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*".

➢ AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditimin në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit "Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin *'Mbi ankesën e banorëve të fshatit Piskovë për venddepozitimin ekzistues të mbetjeve urbane*", për periudhën objekt auditimi 01.01.2019 deri në 29.07.2024, përcjellë me shkresën nr.968/29 prot., datë 04.04.2025, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

1.Hartimi i programit (Plani i veprimit) me personat përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve;

2.Realizimi i programit (Plani i veprimit) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit rekomandimeve brenda afatit 6 mujor;

3.Statusi i rekomandimeve të lëna (sa rekomandime janë pranuar e nga këto sa janë zbatuar plotësisht, pjesërisht, në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar).

4.Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

-Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", gërma j), ku cilësohet se:

"*KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*".

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Në lidhje me raportimin që Agjencia Kombëtare e Mjedisit duhet të bëjë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", pika 2, ku cilësohet se:

"*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*".

-Për sa më lart, Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk ka dërguar raportim në KLSH, në respektim të afatit ligjor brenda 6 muajve, mbi zbatimin e rekomandimeve.

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti "Agjencia Kombëtare e Mjedisit", në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr.968/29 prot., datë 04.04.2025, rezulton se, nga **3** masa të rekomanduara (organizative dhe disiplinore), janë pranuar nga subjekti **3** masa të rekomanduara.

Nga të pranuarat (3): nuk janë zbatuar **3** masa.

Tabela nr. 4: Statusi i zbatimit të rekomandimeve

Lloji i masës	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces zbatimi	Pazbatuar
Organizative	2	-	-	-	2
Disiplinore	1	-	-	-	1
Totali	3	-	-	-	3

II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Nga të dhënat e paraqitura gjatë auditimit nga subjekti i audituar, përgjigjet me shkrim dhe dokumentacioni i tij, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

A.MASA ORGANIZATIVE

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se dosja e aplikimit për VNM paraprake dhe për leje infrastrukturore, përsa i përket venddepozitimit të mbetjeve urbane në Piskovë, ka rezultuar me mangësi në dokumentacion, kjo në kundërshtim me Vendimin nr. 686, datë 29.7.2015 "*Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore*" dhe me Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 18 deri 24 të Raportit të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Bashkia e Përmetit të marrin masa që përpara miratimit të VNM –ve paraprake dhe lejeve infrastrukturore të verifikojnë se aplikimi i kryer është në përputhje me të gjitha kriteret sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

Përgjigjja e institucionit: Aplikimi është kryer nga ″MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT (MTM)", me numër aplikimi AN131020210003, për projektin "Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale", me vendndodhje në bashkinë Përmet.
Kjo procedurë është ndjekur në mbështetje të:
•Ligjit nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" te ndryshuar,
•VKM nr. 686, datë: 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", të ndryshuar;
• Urdhërit të Kryeministrit Nr. 153 Prot, datë: 25.11.2019 "Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data: 01.01.2020";
•Vendimin nr. 10, datë 18.11.2020, të Komitetit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, pranë Ministrisë së Mjedisit (ish Ministria e Turizmit dhe Mjedisit).
Agjencia Kombëtare e Mjedisit, merr në shqyrtim dhe jep vendime për procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. nëpërmjet platformës qeveritare "E-Albania", sistemi "E-Leje" për VNM-të. Zhvilluesi që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekt i kërkesave të nenit 8, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, që në fazat fillestare të planifikimit të projektit (projektidesë), paraqet pranë Ministrisë së Mjedisit projektin nëpërmjet sistemi "E-Leje.
Gjatë procedurës së VNM-së, AKM-ja dhe ministria, sipas kompetencave, konsultohen edhe me institucionet e përmendura në shkronjat "c", "ç" dhe "dh" të pikës 1 të nenit 14 të këtij ligji, duke u dërguar edhe kopje të dokumentacionit të paraqitur nga zhvilluesi i projektit.
Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka dhënë vendim për projektin "Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga venddepozitimet ilegale", vendimi për VNM-në Paraprake është dhënë mbështetur në deklarimet e bëra në aplikim nga zhvilluesi. Në akt janë vendosur harta dhe koordinatat e deklaruara nga zhvilluesi në bashkëpunim me strukturat përkatëse pranë Bashkisë Përmet. Subjekti duhet të pajiset me lejen e ndërtimit dhe me nisjen e punimeve duhet të raportojë pranë AKM, gjithashtu dhe pajisjen me Lejen e Mjedisi për veprimtarinë.
Nëse veprimtara apo projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës apo vendimi për VNM-në, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.
Në zbatim të Ligjit nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit, kur shqyrton dhënien ose jo të miratimit të zhvillimit për një projekt ose vendosjen e kushteve për zhvilluesin, merr në konsideratë deklaratën mjedisore ose vendimin për VNM-në paraprake për ndikimet në mjedis të projektit të propozuar.

-Në rast se autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit të projektit merr vendim për miratimin e zhvillimit të projektit në kundërshtim me vendimin për VNM-në paraprake apo deklaratën mjedisore, jep argumentet përkatëse për këtë vendim.
Referuar zbatimit të rekomandimeve ju informojmë se bazuar në vendimin e dhënë nga AKM, është në përputhje me të gjitha kriteret sipas legjislacionit në fuqi, ky është një detyrim ligjor që duhet të argumentohet nga strukturat përkatese të Bashkisë Përmet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përgjigjja e mësipërme është paraqitur nga subjekti "*Agjencia Kombëtare e Mjedisit*", gjatë auditimit tematik të mëparshëm "*Mbi ankesën e banorëve të fshatit Piskovë*". Gjatë këtij auditimi, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk janë paraqitur argumenta të rinj për zbatimin e rekomandimit.
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar.**

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer rezultoi se institucionet me funksion inspektimi si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nuk kanë kryer inspektime në venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë dhe në zonën e mbrojtur Parku Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli", kjo në kundërshtim me Ligjin nr.81/2017 "*Për zonat e mbrojtura*", i ndryshuar, neni 38, pika 1 dhe me Ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 "*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*" i ndryshuar, neni 25/1, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr.32 deri 34 të Raportit të Auditimit).*
-Nga auditimi konstatohet se Bashkia Përmet nuk ka kryer një monitorim (të venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë), i cili të përmblidhet në një raport ku të vendosen të dhëna si: monitorimi i gjendjes në tërësi të venddepozitimit, monitorimi i gjendjes së murit mbajtës, monitorimi i sistemit të kullimit etj, në kundërshtim me Vendimin nr. 452, datë 11.7.2012 "*Për lendfillet e mbetjeve*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr.33 deri 33 të Raportit të Auditimit).*
Rekomandimi 7.1: Drejtoria e Kontroll-Inspektimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të marrë masa për të inspektuar Bashkinë e Përmetit, në lidhje me menaxhimin e mbetjeve si dhe venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, raport i cili të dërgohet edhe në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Përgjigjja e institucionit: Në bazë të Rekomandimit i cili parashikon marrjen e masave për inspektimin e Bashkisë Përmet në lidhje me menaxhimin e mbetjeve dhe venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, vlerësohet se përgjegjësia kryesore për ndërhyrje dhe zbatim të masave konkrete në terren i takon strukturave të pushtetit vendor dhe inspektorateve përgjegjëse për kontrollin e territorit.
Konkretisht, Bashkia Përmet, në cilësinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore, ka detyrimin ligjor për organizimin, administrimin dhe monitorimin e sistemit të menaxhimit të mbetjeve brenda territorit të saj administrativ, përfshirë garantimin e standardeve për depozitimin e mbetjeve urbane, në përputhje me Ligjin nr. 57/2025 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve". Çdo mungesë në përmbushjen e këtyre detyrimeve përbën përgjegjësi institucionale të saj.
Nga ana tjetër, Drejtoria e Inspektim-Kontrollit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit ushtron veprimtarinë e saj inspektuese vetëm ndaj subjekteve të pajisura me Leje Mjedisore të tipit A dhe B, duke verifikuar përputhshmërinë e aktivitetit të tyre me kushtet e përcaktuara në këto leje, në përputhje me Ligjin nr. 10448/2011 "Për lejet e mjedisit", Ligjin nr. 10431/2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", si dhe Ligjin nr. 99/2024 "Për inspektimet në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 568/2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit".

Njëkohësisht, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) dhe Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) kanë kompetencën për të verifikuar dhe ndërhyrë ndaj subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje apo në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, si dhe në rastet e ndotjes nga burime lokale, në përputhje me VKM nr. 509/2025 dhe Urdhrin e Inspektoratit Qendror nr. 29/2023.
Në këtë kuadër, zbatimi i Rekomandimit kërkon bashkërendim ndërmjet Bashkisë Përmet, e cila mban përgjegjësinë për menaxhimin e mbetjeve dhe përmirësimin e situatës në terren, dhe strukturave inspektuese IMT/IKMT, të cilat duhet të ushtrojnë kompetencat e tyre ligjore për kontrollin dhe ndëshkimin e çdo shkeljeje të konstatuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Për zbatimin e këtij rekomandimi, Drejtoria e Kontroll-Inspektimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit nuk ka marrë kryer asnjë procedurë inspektimi në Bashkinë e Përmetit, me objekt "*menaxhimin e mbetjeve urbane*".
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar.**

C.MASA DISIPLINORE DHE ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; germat (a, b, c, ç) e nenit 58-"Llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*"; kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejtje", neni 58, pika a, për:

-**Z. D. S.**, në cilësinë e Drejtorit të Inspektim-Kontrollit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për moszbatimin e Ligjit nr.10440, datë 07.07.2011 "*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*" i ndryshuar, neni 25/1, pika 3.

-**Znj. E. M.**, në cilësinë e përgjegjëses pranë sektorit të VNM-së, Agjencia Kombëtare e Mjedisit për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 "*Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".*

-Znj. J. M.- në cilësinë e anëtares së komisionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 "*Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".*

-Znj. J. T.- në cilësinë e anëtares së komisionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 "*Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".*

-Znj. E. Z.- në cilësinë e anëtares së komisionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 "*Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".*

-Z. O. Dh.- në cilësinë e anëtarit të komisionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 "*Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".*

Përgjigjja e institucionit: Bazuar në pikën b) të Nenit 59 të Ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, komisioni disiplinor fillon procedimin me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me komptenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar ose auditimi, si dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullova për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", Titullari i Institucionit me vënien në dijeni të nje shkeljeje duhet tja drejtojë Komisionit Disiplinor.
Sa më sipër këto rekomandime nuk janë kaluar për shqyrtim në komision disiplinor.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së: Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pazbatuar.**

III.KONKLUZIONI I AUDITIMIT:

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr.968/29 prot., datë 04.04.2025 në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit rezultoi se nga 3 rekomandime (masa organizative dhe masa disiplinore), janë pranuar nga subjekti 3 rekomandime ose 100 % e tyre. Nga këto nuk janë zbatuar 3 rekomandime, ose 100 % e tyre.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për sa më sipër, ri-kërkojmë që, Agjencia Kombëtare e Mjedisit të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë: të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi, brenda 6-muajve.

A. MASA ORGANIZATIVE:

2.1.Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Bashkia e Përmetit të marrin masa që përpara miratimit të VNM –ve paraprake dhe lejeve infrastrukturore të verifikojnë se aplikimi i kryer është në përputhje me të gjitha kriteret sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Kontroll-Inspektimit në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të marrë masa për të inspektuar Bashkinë e Përmetit, në lidhje me menaxhimin e mbetjeve, si dhe me venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, raport i cili të dërgohet edhe në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

C.MASA DISIPLINORE DHE ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; germat (a, b, c, ç) e nenit 58-"Llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*"; kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:
"Vërejtje", neni 58, pika a, për:
-**Z. D. S.**, në cilësinë e Drejtorit të Inspektim-Kontrollit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për moszbatimin e Ligjit nr.10440, datë 07.07.2011 "*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*" i ndryshuar, neni 25/1, pika 3.
-**Znj. E. M.**, në cilësinë e përgjegjëses pranë sektorit të VNM-së, Agjencia Kombëtare e Mjedisit për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 "*Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve*

për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".

-Znj. J. M.- në cilësinë e anëtares së komisionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 "*Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".*

-Znj. J. T.- në cilësinë e anëtares së komisionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 "*Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".*

-Znj. E. Z.- në cilësinë e anëtares së komisionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 "*Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".*

-Z. O. Dh.- në cilësinë e anëtarit të komisionit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit për moszbatimin e Vendimit nr. 686, datë 29.7.2015 "*Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore".*

- **AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditimin në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura "Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin *'Mbi ankesën e banorëve të fshatit Piskovë për vend-depozitimin ekzistues të mbetjeve urbane*", për periudhën objekt auditimi 01.01.2019 deri në 29.07.2024, përcjellë me shkresën nr.968/27 prot., datë 04.04.2025, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

1.Hartimi i programit (Plani i veprimit) me personat përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve;

2.Realizimi i programit (Plani i veprimit) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit rekomandimeve brenda afatit 6 mujor;

3.Statusi i rekomandimeve të lëna (sa rekomandime janë pranuar e nga këto sa janë zbatuar plotësisht, pjesërisht, në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar).

4.Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", gërma j), ku cilësohet se:

"*KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*".

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Në lidhje me raportimin që Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura duhet të bëjë në Kontrollin e

Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", pika 2, ku cilësohet se:
"*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*".
Për sa më lart, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nuk ka dërguar raportim në KLSH, në respektim të afatit ligjor brenda 6 muajve, mbi zbatimin e rekomandimeve.

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti "Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura", në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr.968/27 prot., datë 04.04.2025, rezulton se, nga **1** masë e rekomanduar (organizative), është pranuar nga subjekti **1** masë e rekomanduar.
Nga të pranuarat (1): është zbatuar plotësisht **1** masë.
Tabela nr. 5: Statusi i zbatimit të rekomandimeve

Lloji i masës	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces zbatimi	Pazbatuar
Organizative	1	1	-	-	-
Disiplinore	0	-	-	-	-
Totali	1	1	-	-	-

Përpunoi: Grupi i auditimit.

II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Nga të dhënat e paraqitura gjatë auditimit nga subjekti i audituar, përgjigjet me shkrim dhe dokumentacioni i tij, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer rezultoi se institucionet me funksion inspektimi si Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura nuk kanë kryer inspektime në venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë dhe në zonën e mbrojtur Parku Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli", kjo në kundërshtim me Ligjin nr.81/2017 "*Për zonat e mbrojtura*", i ndryshuar, neni 38, pika 1 dhe me Ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 "*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*" i ndryshuar, neni 25/1, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr.32 deri 34 të Raportit të Auditimit).*
-Nga auditimi konstatohet se Bashkia Përmet nuk ka kryer një monitorim (të venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë), i cili të përmblidhet në një raport ku të vendosen të dhëna si: monitorimi i gjendjes në tërësi të venddepozitimit, monitorimi i gjendjes së murit mbajtës, monitorimi i sistemit të kullimit etj, në kundërshtim me Vendimin nr. 452, datë 11.7.2012 "*Për lendfillet e mbetjeve*", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr.33 deri 33 të Raportit të Auditimit).*
7.2 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura Gjirokastër të marrë masa për të bërë kontrolle në Parkun Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli", konkretisht venddepozitimin e mbetjeve urbane në fshatin Piskovë me qëllim mbrojtjen e burimeve bionatyrore nga dëmtimet, zjarri, të ndotjes së mjedisit, etj.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

Përgjigjja e institucionit:
Në përgjigje të rekomandimit për marrjen e masave lidhur me kontrollin e venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë, pjesë e Parku Kombëtar Bredhi i Hotovës-Dangëlli, ju bëjmë me dije se Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, në bashkëpunim me Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Gjirokastër, ka ushtruar dhe vijon të ushtrojë në mënyrë të plotë dhe të pandërprerë kompetencat e saj ligjore në drejtim të monitorimit, kontrollit dhe mbrojtjes së territorit të zonave të mbrojtura.Në këtë kuadër, strukturat përgjegjëse të AKZM/AdZM kanë kryer në mënyrë sistematike monitorime në terren brenda zonave të mbrojtura që administrojnë, përfshirë edhe Parkun Kombëtar

"Bredhi i Hotovës-Dangëlli". Këto monitorime janë dokumentuar dhe raportuar në mënyrë periodike pranë AKZM-së, duke garantuar ndjekjen e vazhdueshme të situatës në terren dhe reagimin në kohë ndaj çdo problematike të evidentuar.Në vijim të çështjes konkrete, është ngritur një grup pune i posaçëm për verifikimin në terren të venddepozitimit të mbetjeve urbane në fshatin Piskovë. Në datën 19.12.2024, grupi i punës ka kryer inspektimin përkatës në terren, gjatë të cilit është konstatuar dhe pasqyruar në mënyrë të detajuar gjendja faktike e venddepozitimit. Gjetjet janë reflektuar në raportin zyrtar të hartuar për këtë qëllim, si dhe në procesverbalin përkatës të mbajtur nga grupi i punës.Në procesverbalin e hartuar janë përcaktuar qartë detyra konkrete për vijimin e monitorimeve të vazhdueshme mbi këtë vendgrumbullim, me fokus të veçantë në vlerësimin e ndikimeve potenciale në ekosistemin e zonës së mbrojtur, si dhe është vendosur detyrimi për raportime periodike pranë AKZM-së mbi çdo zhvillim të konstatuar.Në zbatim të këtyre detyrimeve, Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Gjirokastër ka vijuar monitorimet sistematike gjatë periudhës Janar 2025 – Mars 2026, duke kryer kontrolle të vazhdueshme në terren. Rezultatet e këtyre monitorimeve janë përcjellë rregullisht pranë AKZM-së nëpërmjet raporteve mujore të punës, duke siguruar një mekanizëm të qëndrueshëm ndjekjeje dhe raportimi mbi situatën.Sa më sipër, evidentohet se institucioni ynë jo vetëm ka reaguar në mënyrë të menjëhershme ndaj rekomandimit, por ka ngritur dhe zbatuar një mekanizëm të qëndrueshëm kontrolli dhe monitorimi në vijimësi, në përputhje të plotë me kompetencat dhe detyrimet ligjore në fuqi.Dokumentacioni i sipërcituar përcillet bashkëlidhur në version elektronik, në mbështetje të sa parashtrohet në këtë shkresë.Institucioni ynë mbetet plotësisht i angazhuar për forcimin e mëtejshëm të masave mbrojtëse, garantimin e integritetit të zonave të mbrojtura dhe parandalimin e çdo veprimtarie që cenon mjedisin dhe burimet natyrore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion nga ana e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura rezulton se: AKZM në bashkëpunimin me AdZM Gjirokastër kanë kryer monitorime brenda zonës së mbrojtur "Parku Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli".
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar.**

III.KONKLUZIONI I AUDITIMIT:

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se nga KLSH me shkresën nr. 969/27 prot., datë 04.04.2025 është rekomanduar vetëm 1 masë organizative në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Nga verifikimi i kryer rezultoi se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna është pranuar dhe është zbatuar plotësisht nga subjekti, në masën 100%.

- **MINISTRIA E MJEDISIT**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditimin në Ministrinë e Mjedisit "Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin *'Mbi ankesën e banorëve të fshatit Piskovë për vend-depozitimin ekzistues të mbetjeve urbane*", për periudhën objekt auditimi 01.01.2019 deri në 29.07.2024, përcjellë me shkresën nr.968/30 prot., datë 04.04.2025, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

1.Hartimi i programit (Plani i veprimit) me personat përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve;

2.Realizimi i programit (Plani i veprimit) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit rekomandimeve brenda afatit 6 mujor;

3.Statusi i rekomandimeve të lëna (sa rekomandime janë pranuar e nga këto sa janë zbatuar plotësisht, pjesërisht, në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar).

4.Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve e lëna.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprim në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", gërma j), ku cilësohet se:

"*KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*".

Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Në lidhje me raportimin që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit duhet të bëjë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", pika 2, ku cilësohet se:

"*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*".

Për sa më lart, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka dërguar raportim në KLSH, në respektim të afatit ligjor brenda 6 muajve, mbi zbatimin e rekomandimeve.

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti "Ministria e Mjedisit", në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr.968/30 prot., datë 04.04.2025, rezulton se, nga **4** masa të rekomanduara (organizative dhe disiplinore), janë pranuar nga subjekti **4** masa të rekomanduar.

Nga të pranuarat (4): janë zbatuar plotësisht **2** masa, është zbatuar pjesërisht **1** masë dhe është në proces zbatimi **1** masë.

Tabela nr. 6: Statusi i zbatimit të rekomandimeve

Lloji i masës	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces zbatimi	Pazbatuar
Organizative	3	1	1	1	-
Disiplinore	1	1	-	-	-
Totali	4	2	1	1	-

Përpunoi: Grupi i auditimit.

II. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Nga të dhënat e paraqitura gjatë auditimit nga subjekti i audituar, përgjigjet me shkrim dhe dokumentacioni i tij, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Komiteti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve vendosi rehabilitimin e venddepozitimit të Brackovës[3], me qëllim për të rritur kohën e funksionimit të tij. Ndërkohë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në rolin e zhvilluesit, nisi procedurën e aplikimit për tu pajisur me VNM paraprake dhe me leje infrastrukturore, për ndërtimin e një venddepozitimi të ri në fshatin Piskovë, veprime në kundërshtim me Vendimin e Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, nr.10, datë 18.11.2020. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr. 9 deri 15 të Raportit të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrë në shqyrtim rastin e mësipërm duke nxjerrë të gjitha përgjegjësitë, si dhe të marrë masa që në të ardhmen këto praktika t'i kryejë konform dispozitave ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

[3] E konfirmuar edhe nga observacionet e sjella nga nëpunësi civil që ka mbajtur protokollin e takimit të Komitetit të Menaxhimit të Mbetjeve.

Përgjigjja e institucionit:
Landfilli rajonal për Bashkitë Përmet dhe Këlcyrë, që përfshihen në zonën e mbetjeve Vlorë-Jug-Gjirokastër është landfilli i Bajkajt. Në këtë zonë mbetjesh po zbatohet projekti IPA 'BE për Ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër", në periudhën Janar 2024-2028. Në këtë kuadër është realizuar studimi preliminary detailed design për infrastrukturën rajonale të mbetjeve të zonës së mbetjeve Vlorë Jug-Gjirokastër që përfshin:

- Landfillin rajonal të mbetjeve Bajkaj (Delvinë);
- Katër Stacione transferimi të mbetjeve:
- Gjirokastër;
- Tepelenë-Memaliaj;
- Përmet-Këlcyrë dhe
- Himarë.

Stacioni i Transferimit Përmet-Këlcyrë është dakortësuar vendndodhja dhe është konfirmuar pronësia e tokës (email dhe dokumentacioni bashkëlidhur) dhe ka filluar studimi nga konsulentët ndërkombëtarë dhe vendas.
Gjithashtu është dakortësuar lista me 12 venddepozitime ekzistuese të cilat do të mbyllen dhe të rehabilitohen, brenda afatit të zbatimit dhe me financimin e projektit. Në këtë listë janë të përfshira dhe dy venddepozitimet e Bashkisë Përmet: Piskovë dhe Brackovë, për të cilat është në proces studimi detailed design.

Përgjigjja e Institucionit:
Sa lidhet me investimet në infrastrukturën e mbetjeve sqarojmë se: me ngritjen e AKEM (Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve) në Mars 2024 dhe më pas me transformimin e saj në AKEM sh.a, në Janar 2026, ky institucion ndjek këto praktika në përputhje të plotë me kuadrin ligjor vendas dhe procedurat respektive.
Të dyja venddepozitimet në Brackovë dhe Piskovë do të mbyllen dhe rehabilitohen në kuadër të projektit IPA "BE për Ekonominë Qarkulluese dhe rritjen e gjelbër", që ka filluar nga zbatimi në Janar 2024. Studimi detailed design për këto dy venddepozitime është në proces dhe do të vijohet me zbatimin për rehabilitimin e këtyre venddepozitimeve në territorin e Bashkisë Përmet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë pjesërisht masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Referuar përgjigjes, rekomandimi nuk mund të konsiderohet i zbatuar plotësisht, pasi strukturat përgjegjëse pranë Ministrisë së Mjedisit nuk kanë marrë në shqyrtim rastin e mësipërm (*pasqyruar në gjetjen nr.1*) si dhe nuk kanë nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht.**

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sipas Planit Kombëtar Sektoral për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr.1, datë 13.01.2020, në Bashkinë e Përmetit dhe në Bashkinë e Këlcyrës është parashikuar ndërtimi i një stacioni transferimi mbetjesh urbane. Nëpërmjet një përgjigje me e-mail (datë 11.09.2024) nga Bashkia Përmet, vendndodhja e stacionit të mbetjeve urbane nuk është miratuar ende nga institucionet kompetente. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe nr. 21 deri 22 të Raportit të Auditimit).*
3.1.Rekomandimi: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve dhe Bashkinë e Përmetit, të koordinojnë punën për përcaktimin e vendndodhjes së venddepozitimit rajonal dhe të vijohet me ndërtimin e tij.

Brenda datës 31.12.2025.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **është në proces zbatimi.**

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në dosjen e prokurimit "Shërbim konsulence", mungon "marrëveshja e noterizuar" ndërmjet operatorëve ekonomik, në kundërshtim me nenin 44, pika 2 të Ligjit nr. 9643 *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar dhe nenit 74, pika 2 dhe 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për rregullat e prokurimit publik". (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 28 deri 29 të Raportit të Auditimit).*

6.1.Rekomandim: Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për verifikimin e saktë të dokumentacionit të dorëzuar nga ana e operatorëve ekonomik.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

Përgjigjja e institucionit:
Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në procedurat e prokurimeve në vazhdim do të marrë të gjitha masat që çdo dokumentacion të dorëzuar nga operatorët ekonomik të verifikohen dhe të administrohen në mënyrë të saktë sipas përcaktimeve në LPP. Autoriteti Kontraktor ish-Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, aktualisht Ministria e Mjedisit nga periudha Prill 2025 dhe në vazhdim nuk ka zhvilluar asnjë procedurë prokurimi me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla. Gjithashtu, theksojmë se, në zbatim të të VKM-së nr.531, datë 07.09.2023 "Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" sh.a, për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të Varësisë", të ndryshuar, procedurat që janë me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, dërgohen për t'u zhvilluar pranë "Operatorit të Blerjeve të Përqendruara" sh.a. në cilësinë e Organit Qëndror Blerës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit. Përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit gjatë takimit me grupin e auditimit kthyen përgjigje se "*nga muaji prill 2025-30.04.2026, Ministria e Mjedisit nuk ka kryer asnjë procedurë prokurimi për ndërtimin e vend-depozitimeve të reja urbane në territorin e Republikës së Shqipërisë*".
Për sa më lart, Ministria e Mjedisit ka marrë parasysh rekomandimin dhe gjatë kësaj periudhe nuk ka kryer asnjë procedurë prokurimi për vend-depozitim mbetjesh.
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht.**

C.MASA DISIPLINORE DHE ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; germat (a, b, c, ç) e nenit 58-"Llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*"; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*"; kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejtje", neni 58, pika a, për:

1.Znj. Sh. H., me detyrë specialiste në Sektorin e Tërheqjes së Financimit dhe Partneritetit në Turizëm dhe Mjedis, në cilësinë e anëtares të Njësisë së Prokurimit për Hartimin e Dokumenteve të Tenderit, pasi nuk ka ndjekur hapat për pasqyrimin e dokumentacionit dhe procedurës sipas nenit 4 të VKM nr.914 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" dhe pikës 3 të Udhëzimit nr.1, datë 05.01.2018 të APP, pasi kriteret e veçanta të vendosura nuk janë të argumentuara dhe nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm, pikës 1 të nenit 46, të LPP, si dhe nenit 28 të VKM nr. 914 "*Për rregullat e prokurimit publik*". NJP në këtë rast ka kryer ndryshimet e kërkuara sipas direktivave

të APP, por ato nuk janë të dokumentuara dhe të argumentuara sipas përcaktimeve të nenit 61, pika 2 e VKM nr.914.

2.**Z. Sh.K.** me detyrë specialist në Sektorin e Shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Për Marrjen në Dorëzim, pasi dokumentat e mbajtura pas kryerjes së studimeve si: studimi topografik, studimi gjeologjik, studimi hidrologjik, raport i VNM-së dhe dokumenta që kanë të bëjnë me studimin funksional të lendfillit nuk janë të nënshkruara dhe të konfirmuara nga personat përgjegjës të cilët kanë kryer studimin, në kundërshtim me nenin 2/j të VKM-së nr.285/2021.

5.**Znj. D. P.**, në cilësinë e titullarit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, për moszbatimin e Ligjit nr. 81/2017 "*Për zonat e mbrojtura*", i ndryshuar, neni 38, pika 1.

Përgjigjja e institucionit:

Njësia e Burimeve Njerëzore, në zbatim të rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, përmes shkresës nr. 2648, datë 07.04.2025, për Auditimin Tematik "Mbi ankesën e banorëve të fshatit Piskovë për venddepozitimin ekzistues të mbetjeve urbane", hartoi MEMO-n informuese me nr. 2648/1, datë 5.5.2025, përmes të cilës informoi titullarët e institucionit mbi hapat që parashikohen në legjislacionin civil lidhur me rekomandimin e raportit përfundimtar të Auditimit nga KLSH për fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore për 3 punonjës: znj.Sh.H., z.Sh. K. dhe znj.D.P.

NJBNJ rekomandoi që eprori direkt i secilit punonjës të bënte vlerësimin dhe klasifikimin e shkeljes disiplinore të konstatuar dhe të niste ecurinë displinore (bashkëlidhur gjeni MEMO-n përkatëse).

P*ër znj. Sh. H.* me detyrë specialiste në Sektorin e Tërheqjes së Financimit dhe Partneritetit në Turizëm dhe Mjedis, Eprori direkt i saj znj. F. C., Drejtor i Drejtorisë së Ndryshimeve Klimatike, ndoqi hapat procedurialë:

1. Njoftim i punonjësit për nisje të ecurisë disiplinore, me shkresën nr 6102 prot., datë 20.8.2025, njoftim i cili përmban të gjithë elementët ligjorë të nevojshëm; shkeljen e pretenduar, të drejtën e punonjësit për t'u dëgjuar e për t'u përfaqësuar, datën dhe orën e seancës dëgjimore;
2.Procesverbal mbi takimin e mbajtur në kuadër të fillimit të ecurisë disiplinore ndaj punonjëses Sh. H., me nr 6102/1, datë 28.8.2025, procesverbal i cili përmban të gjitha diskutimet dhe argumentet e paraqitura nga palët;
3. Vendim "Për ndërprerjen e ecurisë disiplinore", me nr 6102/2 prot., datë 1.9.2025, me argumentet e trajtuara dhe vendimmarrjen përfundimtare (bashkëlidhur gjeni kopje të secilit dokument të sipërcituar).

P*ër z. Sh. K.* me detyrë specialist në Sektorin e Shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për marrjen në dorëzim, Eprori direkt i tij, znj. I. B., Drejtor i Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, ndoqi hapat procedurialë:

1.Njoftim i punonjësit për nisje të ecurisë disiplinore, me shkresën nr 5961 prot., datë 8.8.2025, njoftim i cili përmban të gjithë elementët ligjorë të nevojshëm; shkeljen e pretenduar, të drejtën e punonjësit për t'u dëgjuar e për t'u përfaqësuar, datën dhe orën e seancës dëgjimore;
2.Shkresë e paraqitur nga z. K., me nr 5961/1, datë 11.8.2025, i cili paraqet disa argumente mbi shqyrtimin e shkeljeve të parashtruara në raportin përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditim Tematik "Mbi ankesën e banorëve të fshatit Piskovë për venddepozitimin ekzistues të mbetjeve urbane";
3.Procesverbal mbi takimin e mbajtur në kuadër të fillimit të ecurisë disiplinore ndaj Z. K., me nr 5961/2, datë 18.8.2025, procesverbal i cili përmban të gjitha diskutimet dhe argumentet e paraqitura nga palët;
4. Vendim "Për ndërprerjen e ecurisë disiplinore", me nr 5961/3 prot., datë 20.8.2025, me argumentet e trajtuara dhe vendimmarrjen përfunndimtare (bashkëlidhur gjeni kopje të secilit dokument të sipërcituar).

Për znj. D.P. në cilësinë e titullarit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Eprori direkt i saj, në këtë rast Nëpunësja më e lartë civile në Ministri, znj. L.B. A., Sekretare e Përgjithshme, ndoqi hapat procedurialë:
1. Njoftim i punonjësit për nisje të ecurisë disiplinore, me shkresën nr 5821 prot., datë
31.7.2025, njoftim i cili përmban të gjithë elementët ligjorë të nevojshëm; shkeljen e pretenduar, të drejtën e punonjësit për t'u dëgjuar e për t'u përfaqësuar, datën dhe orën e seancës dëgjimore;
2.Procesverbal mbi takimin e mbajtur në kuadër të fillimit të ecurisë disiplinore ndaj
Titullares së AKZM, znj. D. P., me nr 5821/1, datë 11.8.2025, procesverbal i cili përmban të gjitha diskutimet dhe argumentet e paraqitura nga palët;
3. Vendim "Për ndërprerjen e ecurisë disiplinore", me nr.5821/2 prot., datë 13.8.2025, me argumentet e trajtuara dhe vendimmarrjen përfundimtare (bashkëlidhur gjeni kopje të secilit dokument të sipërcituar).
Krahas sqarimeve në këtë rubrikë, bashkëlidhur do të gjeni dokumentacionin për këto procedura disiplinore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit vendosur në dispozicion si dhe argumentimeve të kryera nga ana e Institucionit, (personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve) rezulton se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimit.
Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe pjesërisht **zbatuar plotësisht.**

III.KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 968/30 prot., datë 04.04.2025 në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit rezultoi nga 4 rekomandime (masa organizative dhe masa disiplinore), janë pranuar nga subjekti 4 rekomandime ose 100 % e tyre. Nga këto janë zbatuar plotësisht 2 rekomandime, ose 50 % e tyre, është në proces zbatimi 1 rekomandim ose 25 % dhe është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim ose 25% e tyre.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për sa më sipër, ri-kërkojmë që, Ministria e Mjedisit të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të: të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e zbatimit të rekomandimeve, të cilat rezultojnë në proces zbatimi, brenda 6-muajve.

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.1.Rekomandimi: Ministria e Mjedisit, të marrë në shqyrtim rastin e mësipërm duke nxjerrë të gjitha përgjegjësitë, si dhe të marrë masa që në të ardhmen këto praktika t'i kryejë konform dispozitave ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

3.1.Rekomandimi: Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve dhe Bashkinë e Përmetit, të koordinojnë punën për përcaktimin e vendndodhjes së venddepozitimit rajonal dhe të vijohet me ndërtimin e tij.

Menjëherë.

Për sa më sipër u mbajt ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT